VENDIM
Nr. 86, datë 26.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.11.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 50 Akti, që u përket:

KËRKUES: Xhavit Pinari, Nadire Pinari, Qazim Pinari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Eleni Qordja, Gaqo Prushi, Nuri Prushi, Shpresa Tafaj, Lumturi Shehu, Nadire Nunaj, Nazmi Prushi, Bajram Pinari, Qerim Pinari, Vaje Pinari, Hajrije Pinari, Bedrije Koçi (Pinari), Bakushe Isaku (Pinari), Luljeta Tresa (Pinari), Shoqëria “Mateo Konstruksion” SHPK

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 2857, datë 27.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 2857, datë 27.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në momentin e dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Palët ndërgjyqëse në procesin gjyqësor civil janë trashëgimtarë të shtetasit M.P., i cili, në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi, është trajtuar dhe pajisur nga ana e Komisionit të Tokës së fshatit Selitë me një sipërfaqe toke bujqësore, siç rezulton nga vendimet gjyqësore. Pala paditëse në procesin gjyqësor (subjektet e interesuara), duke pretenduar se është trajtuar me tokë bujqësore dhe se janë anëtarë të tokës bujqësore, ka paraqitur padi në gjykatë, duke pretenduar detyrimin e palës së paditur që t’i njohë bashkëpronarë mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor, regjistrimin e këtyre pasurive në ZVRPP sipas pjesëve takuese dhe zgjidhjen e pasojave juridike të kontratave të pavlefshme të lidhura midis të paditurve Pinari dhe një shoqërie ndërtimore.

2. Me vendimin nr. 3278, datë 1.4.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesëpadisë*”.

3. Me vendimin nr. 2857, datë 27.6.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 3278, datë 1.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve trashëgimtarë të R.P. (V.P., H.P., B.K., B.I., L.T., Q.P., XH.P.) të njohin paditësen E.Q.*

bashkëpronarë për sipërfaqen e tokës prej 11.300 m² të përfituar me AMT-në nr. 28 akti, për 1/5 pjesë të kësaj sipërfaqe. Detyrimin e të paditurve trashëgimtarë të R.P. (V.P., H.P., B.K., B.I., L.T., Q.P. e XH.P.) të njohin paditësit G.P., N.P., SH.T., L.SH., N.N. dhe N.P. bashkëpronarë mbi sipërfaqen 11.300 m² tokë bujqësore e fituar me AMT-në nr. 28 akti, bashkërisht për 1/5 pjesë të kësaj sipërfaqe, ose 1/6 e 1/5 secili. Regjistrimin e pjesëve takuese të këtyre sipërfaqeve në favor të paditësve në ZRPP-në Tiranë. Detyrimin e të paditurit B.P. të njohë paditësen E.Q. bashkëpronare për sipërfaqen e tokës prej 10.000 m² të fituar sipas VKM-së nr. 161, datë 8.4.1993, për 1/5 e saj. Detyrimin e të paditurit B.P. të njohë paditësit G.P., N.P., SH.T., L.SH., N.N. dhe N.P. bashkëpronarë për sipërfaqen 10.000 m² bashkërisht për 1/5 pjesë të saj. Regjistrimin e sipërfaqes prej 10.000 m² në ZRPP-në Tiranë në emër të paditësve sipas pjesëve takuese përkatëse të mësipërme. Detyrimin e të paditurit Q.P. të njohë paditësen E.Q. bashkëpronare për 1/5 pjesë të sipërfaqes 10.950 m² tokë bujqësore, të përfituar sipas ligjit "Për tokën" dhe VKM-së nr. 161, datë 8.4.1993. Detyrimin e të paditurit Q.P. të njohë paditësit G.P., N.P., SH.T., L.SH., N.N. dhe N.P. bashkëpronarë bashkërisht për 1/5 pjesë të sipërfaqes së mësipërme prej 10.950 m². Regjistrimin e pjesëve takuese të paditësve mbi këto sipërfaqe në ZRPP-në Tiranë. Ndryshimin e pasojave juridike të rrjedhura nga zbatimi i kontratës së sipërmarrjes nr. 603 rep., nr. 141 kol., datë 27.1.2008, duke u detyruar të paditurit në këtë gjykim, trashëgimtarët e R.P. dhe B.P., si dhe shoqëria "Mateo Konstruksion" sh.p.k., t`i njohë paditëses E.Q. si dhe paditësve G.P., N.P., SH.T., L.SH., N.N. dhe N.P. të drejtën e përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektin e ndërtuar në truallin objekt gjykimi – në raport me pjesët e tyre takuese të truallit në bashkëpronësi, të përcaktuara si më lart në këtë dispozitiv të vendimit.". Kundër këtij vendimi pala e paditur në procesin civil ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, si edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

4. Me vendimin nr. 442, datë 25.11.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2857, datë 27.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me arsyetimin se përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Në lidhje me rekursin, me vendimin nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

II

5. *Kërkuesit Xhavit Pinari, Nadire Pinari dhe Qazim Pinari* i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1 *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë dhe parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit.* Gjykimi në apel është zhvilluar pa pjesëmarrjen e palës së paditur, sepse nuk ka pasur dijeni për gjykimin dhe nuk i janë komunikuar ankimet e palës paditëse. Nënshkrimet për marrjen dijeni në aktet e komunikimit janë të falsifikuara, shkak për të cilin është bërë edhe kallëzim penal, megjithatë organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e çështjes penale me arsyetimin se për këtë pretendim duhet të shprehet gjykata, përderisa çështja është në gjykim. Edhe pse ky pretendim u ngrit në rekurs, ai nuk u mor parasysh.

5.2 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike.* Ky parim vlen jo vetëm për respektimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, por edhe për respektimin e akteve administrative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, siç janë AMTP-të, përderisa këto akte janë në fuqi dhe i prodhojnë rregullisht efektet e tyre për sa kohë që nuk janë shfuqizuar ose ndryshuar nga organi administrativ apo me vendime gjyqësore të formës së prerë.

5.3 Ndërsa gjykata e shkallës së parë i ka qëndruar praktikës gjyqësore, Gjykata e Apelit, pa argumente faktike e ligjore dhe duke injoruar praktikën gjyqësore të konsoliduar, ka mbajtur një qëndrim diametralisht të kundërt dhe ka dhënë një vendim haptazi të padrejtë. I ndodhur para dy vendimeve të kundërta dhe në kushtet kur kishte vendosur pezullimin e ekzekutimit, Kolegji Civil duhej të vendoste shqyrtimin e çështjes në seancë.

5.4. *Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.* Në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është bërë një analizë e saktë dhe e plotë e provave të paraqitura dhe ato janë vlerësuar sipas vlerës provuese,

duke u arritur në konkluzione të sakta e të drejta faktike. Në të kundërt, në vendimin e saj Gjykata e Apelit shprehet vetëm se tokat e fshatit Selitë janë përfshirë në ndërmarrjen bujqësore, por nuk ka përcaktuar se kur është krijuar ajo, kur i kanë kaluar tokat në pronësi, cila ishte përbërja e familjes bujqësore të trashëgimlënësit në atë kohë, cilët nga paditësit kanë qenë të punësuar në atë ndërmarrje, periudha e punësimit etj. Ajo nuk ka rrëzuar me kundërargumente arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndaj ky vendim është alogjik dhe nuk është i qartë në formë dhe përmbajtje.

6. ***Subjektet e interesuara, Eleni Qordja, Gaqo Prushi, Nuri Prushi, Shpresa Tafaj, Lumturi Shehu, Nadire Nunaj etj.*** kanë prapësuar para Gjykatës si më poshtë:

6.1 Nëpërmjet vendimeve gjyqësore që përbëjnë objektin e kësaj kërkese, kërkuesve nuk i është cenuar asnjë e drejtë që garantohet nga ligji kushtetues.

6.2 Fakti që tre të paditurit nuk janë anëtarë të ndërmarrjes bujqësore "Gjergj Dimitrovi" është e vërtetuar nga librezat e tyre të punës.

6.3 Mungesa e këtij statusi juridik në momentin e daljes së ligjit për të tre kërkuesit përcakton se kërkesa e parashtruar prej tyre nuk është e nivelit kushtetues.

6.4. Pretendimi se është formuar keq ndërgjyqësia është e gabuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

7. Kërkuesit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000.

8. Në lidhje me legjitimimin *ratione materia*, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në thelb i referohen mënyrës së vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit. Duke qenë çështje me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materia* në lidhje me këtë pretendim.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve

9. Sipas kërkuesve, gjykimi në apel është zhvilluar pa pjesëmarrjen e palës së paditur, ku bëjnë pjesë edhe ata vetë, dhe ata nuk kanë pasur dijeni për gjykimin, pasi nuk u janë komunikuar ankimet e palës paditëse. Sipas tyre, nënshkrimet për marrjen dijeni në aktet e komunikimit janë të falsifikuara, shkak për të cilin është bërë edhe kallëzim penal. Edhe pse ky pretendim u ngrit në rekurs, ai nuk u mor parasysh nga Gjykata e Lartë. Subjektet e interesuara, Eleni Qordja, Gaqo Prushi, Nuri Prushi, Shpresa Tafaj, Lumturi Shehu, Nadire Nunaj etj., kanë prapësuar para Gjykatës se nëpërmjet vendimeve gjyqësore që përbëjnë objektin e kësaj kërkese, kërkuesve nuk i është cenuar asnjë e drejtë që garantohet nga ligji kushtetues.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare *(shih vendimin nr. 37, datë 30.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

12. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërish në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese *(shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të këtij gjykimi rezulton se pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë pala paditëse në procesin gjyqësor (subjektet e interesuara) kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Sipas dëftesave të komunikimit të datës 12.6.2013 rezulton se ankimi i është komunikuar shoqërisë "Mateo Konstruksion", Qerim Pinari etj., Bajram Pinari etj. dhe Nadire Pinari etj. Edhe pse këto akte janë nënshkruar, nuk rezulton se nga kush janë nënshkruar, pasi nuk është shënuar emri i personit të cilit i janë komunikuar, për më shumë nënshkrimi është i njëjtë për të tria dëftesat në emër të të padituve. Sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se në seancën e datës 24.6.2014 Gjykata e Apelit ka verifikuar pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse dhe pala e paditur (kërkuesit) ka qenë në mungesë. Gjykata, pasi ka verifikuar shkaqet e mosparaqitjes, ka vlerësuar se palët janë njoftuar rregullisht me shpallje (dhe pse në dosjen gjyqësore nuk rezulton i administruar ky akt) dhe se nuk ka shkaqe të arsyeshme për mosparaqitjen e palës së paditur . Për këtë arsye ajo ka vendosur ta gjykojë çështjen në mungesë së kësaj pale. Edhe në dy seancat gjyqësore të zhvilluara në datën 27.6.2014, gjykimi dhe më pas shpallja e vendimit janë bërë përsëri në mungesë të palës së paditur ose të përfaqësuesit të tyre.

14. Sipas nenit 447 të KPC-së ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV, të titullit VI, të pjesës I, të këtij kodi, "Për njoftimet e thirrjet në gjykatë". Për rrjedhojë, edhe në rastin e ankimeve zbatohen të njëjtat rregulla procedurale për njoftimin të zbatueshme edhe në shkallën e parë. Megjithatë, në rastin konkret nuk rezulton të jenë zbatuar këto rregulla për njoftimin e rregullt të palëve. Jo vetëm që nuk rezulton që në dosjen gjyqësore të jenë administruar dëftesat e komunikimit për secilën nga palët e paditura, por edhe në ato dëftesa të administruara nuk rezulton se kujt i janë komunikuar ato.

Për më tepër, kërkuesit kanë paraqitur edhe kallëzim në prokurori, duke pretenduar se janë falsifikuar aktet e njoftimit, për të cilin me vendimin e datës 4.4.2015 të prokurorit është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

15. Po ashtu, në lidhje me njoftimin për ditën dhe orën e gjykimit neni 460 i KPC-së ka parashikuar se ai bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë. Sipas nenit 461 të po këtij kodi, mosparaqitja e palëve, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje, nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën. Po sipas kësaj dispozite, gjykata nuk mund ta shqyrtojë çështjen në mungesë atëherë kur dëgjimi i palëve është një nga detyrat e rigjykimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt.

16. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, Gjykata konstaton se nuk është administruar asnjë akt në lidhje me mënyrën dhe datën e njoftimit të kësaj pale për seancën gjyqësore.

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret mospjesëmarrja e kërkuesve në gjykim vë në dyshim respektimin nga ana e gjykatave të detyrimit për njoftimin e rregullt të palëve në procesin gjyqësor, çka bën që ky proces të jetë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

18. Ky pretendim është ngritur edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, megjithatë ai nuk është marrë parasysh nga ajo gjykatë dhe nuk i është dhënë përgjigje. Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) *(shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës Civile, nuk plotëson apo nuk korrigjon mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe të elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

19. Po ashtu, në jurisprudencën kushtetuese çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata ka theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 42, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar edhe në vendimet gjyqësore të kundërshtuara, si dhe në pretendimet e kërkuesve vërehet se në rastin konkret gjykatat e faktit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme konfliktit gjyqësor në fjalë. Për rrjedhojë, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë dhe se gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë në mungesë të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

20. Sipas kërkuesve, parimi i sigurisë juridike vlen jo vetëm për respektimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, por edhe për respektimin e akteve administrative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, siç janë AMTP-të, përderisa këto akte janë në fuqi dhe i prodhojnë rregullisht

efektet e tyre për sa kohë që nuk janë shfuqizuar ose ndryshuar nga organi administrativ apo me vendime gjyqësore të formës së prerë.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar edhe se parimi i shtetit të së drejtës kërkon, gjithashtu, që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet jo vetëm me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e tillë, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se kthimi i drejtpërdrejtë i pronës nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet kur ajo shqyrton ankesat ndaj vendimeve të organeve administrative, nuk përbën tejkalim të juridiksionit gjyqësor (*shih vendimin nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më sipër, në rastin konkret, vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të AMTP-së nga ana e gjykatës nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, për pasojë ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 71/a dhe 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo. Gani Dizdari,